



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 5
15.03.2019

NR. VENDIMI 4
20.03.2019

VENDIM

“PËR ZGJATJEN E AFATIT TË SEKUESTRIMIT”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përbërë prej:

GJYQTARE–IRENA GJOKA

asistuar nga sekretare gjyqësore Blerina Sukaj, sot me datë 20.03.2019, ora 10:00 mori në shqyrtim nëdhomë këshillimi kërkesën me Nr.regj.5, datë 15.03.2019, që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, përfaqësuar në paraqitjen e kërkesës nga prokurori Vladimir Mara.

OBJEKTI: Zgjatja e afatit të masës së sekuestrimit të pasurive në zotërim të shtetasve:

1. **M.H.**, i biri i C. dhe i Z., i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur dhe banues në xxxx, xxx.
2. **A.H.**, i biri i C. dhe i Z., i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur dhe banues në xxxx, xxx.
3. **F.H.**, i biri i C. dhe i Z., i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur dhe banues në xxxx, xxx.

BAZA LIGJORE: Neni 12, paragrafi 3 të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën dhe aktet e paraqitura, bazuar ne nenet 112 të Kodit Penal, nenet 3/1/c;3/4; 5; 7; 11/1/a, 12, 14, 15 e vijues te ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndyshuar me ligjin Nr.70 viti 2017:Si dhe pasi e vlerësoi kërkesën në tërësi;

VËREN

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë i ka paraqitur kësaj gjykate më datë 15.3.2019, kërkesën me objekt zgjatjen e afatit të sekuestrimit te vendosur nga kjo gjykatë me vendimin Nr.20 datë 15.9.2018, për

pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që janë në pronësi e zotërim të shtetasit M.H. A.H. dhe F.H. .

Në përputhje me kërkesat e nenit 12 paragrafi i parë të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar me ligjin Nr.70 viti 2017, kjo gjykatë, brenda afatit 5 ditor mori në shqyrtim kërkesën e prokurorit.

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me datë 08.07.2016 ka regjistruar procedimin penal Nr.134 për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, “ Grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 284, 333/a të Kodit Penal. Nga të dhënat e gumbulluar rezulton se disa persona, shtetas shqiptar ushtronin veprimtarinë e kundraligjshme të kultivimit të bimëve narkotike duke vepruar si grup i strukturuar kriminal.

Me datë 29.04.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka regjistruar procedimin penal Nr.164 për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuara nga neni 283/a/2 i Kodit Penal. Nga të dhënat e grumbulluara rezultoi se shtetasit N.S., M.H., F.H., M.M. ushtronin aktivitet kriminal të trafikimit të lëndëve narkotike nga Shqipëria në drejtim të Italisë.

Me datë 25.09.2017 është vendosur bashkimi i procedimeve penale Nr.134 të vitit 2016 me procedimin penal nr. 164 të vitit 2017 në një procedim penal Nr.134 të vitit 2016.

Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, në kuadër të materialit pasuror Nr.166 datë 24.11.2017, janë kryer verifikimet pasurore në ngarkim të shtetasve **M.H.**, i biri i C. dhe i Z., i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur dhe banues në xxxx, xxx.

;**A.H.**, i biri i C. dhe i Z., i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur dhe banues në 1.xxxx, xxx.;**F.H.**, i biri i C. dhe i Z., i datëlindjes xx.xx.xxxxx, lindur dhe banues në 1.xxxx, xxx.

Në kuadër të verifikimeve pasurore, i është kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, kopje e fashikullit të procedimit penal nr.1994 të vitit 2017, për veprën penale të “*Pastrimit të produkteve të veprës penale*” parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Me shkresën me nr. 1757/1 Prot. A.XH. të datës 20.02.2018, është dërguar gjithë dokumentacioni i administruar në kuadër të procedimit penal nr.1994 të vitit 2017. Në vijim të hetimeve nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ka rezultuar se është bërë kërkesë për vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme të shtetasve M.H., A.H. dhe F.H. dhe familjarëve të tyre.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin Nr.379 datë 29.10.2017, ka vendosur masën e sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme të regjistruara në Z.V.R.P.P.Vlorë në emër të shtetasve M.H., A.H. dhe F.H. dhe konkretisht : Pasuria 21/7-NDN2, Z.K.8603, vol.57 fq.71, e llojit njësi me sipërfaqe totale 157 m², e ndodhur në lagjen “28 Nëntori”, Vlorë, e cila figuron në pronësi të shoqërisë “TURI&MZB” sh.a.; Pasuria 21/7-N3/2, Z.K.8603, vol.61 fq.250, e llojit njësi me sipërfaqe totale 136m², e ndodhur në lagjen “28 Nëntori”, Vlorë, e cila figuron në pronësi të shtetasit F.H.; Pasuria 32/2+1-2, Z.K.8604, vol.33 fq.27, e llojit apartament me sipërfaqe totale 77.7m², e cila figuron në pronësi të shtetasit A.H.; Pasuria me sipërfaqe 69m², apartament banimi në lagjen “Uji i ftohtë”, Vlorë, ndërtuar nga shoqëria “AFA Konstruktion”

sh.p.k. kontraktuar nga shtetasja K.H. në datë 04.04.2016;Pasuria nr.19/140+2-7, me sipërfaqe 104.5m², e ndodhur në Vlorë, Z.K.8604, vol.37, fq.40,në pronësi të shtetasit F.M.; Pasuria 27/131-ND Z.K. 8605, vol.10 fq.32, e llojit ndërtesë me sipërfaqe 156m², e ndodhur në lagjen “28 Nëntori”, Vlorë, e cila figuron në pronësi të shtetasit A.H.;

Me shkresën nr.764/1 prot. (P.H.) datë 23.01.2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ka rezultuar se është regjistruar procedimi penal Nr.165 i vitit 2015, në ngarkim të shtetasit **M.H.**, i cili është marrë si i pandehur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për kryerjen e veprës penale të “*Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve e kryer në bashkëpunim*” parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe i hetuar me masë sigurimi “Arrest me burg”.

Në kuadër të këtij hetimi pasuror dhe në funksion të një hetimi të plotë e të gjithanshëm, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, i është kërkuar informacion të gjitha bankave, Bankës së Shqipërisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Zyrës Kombëtare të Punësimit, dhe Zyrës së Përgjithshme të Pasurive të Paluajtshme dhe nga institucionet e mësipërme është administruar dokumentacioni përkatës.

Në rrethanat sa u parashtrua më sipër, me vendimin me Nr.20, datë 15.9.2018, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, ka vendosur sekuestrimi i një sërë pasurish të luajtshme dhe të paluajtshme në zotërim të shtetasve të mësipërm. Ky vendim është vënë në ekzekutim, duke ngarkuar për ekzekutimin oficerin e policisë gjyqësore Florian Arapi, pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, si dhe iu dërgua administratorit përkatës në Agjensinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Sipas proces-verbaleve përkatës “Për sekuestrimin, marrjen e pasurive dhe dorëzimin tek administratori” përpiluar nga oficeri i policisë gjyqësore pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, Florian Arapi, i cili ka dokumentuar veprimet e kryera në funksion të ekzekutimit, Gjykata njoftohet për ekzekutimin e këtij vendimi, të pasurive të sekuestruara nga data 3.10.2018 dhe në vijim, ku janë mbajtur disa proces-verbale që lidhen me zbatimin e vendimit gjyqësor.

Pala kërkuese, prokurori, në kërkesën objekt gjykimi për zgjatjen e afatit të sekuestrimit në thelb ka parashtruar se, rrethanat e procedimit pasuror ndaj shtetasve M.H., A.H., F.H. dhe personave familjarë dhe të tij janë po ato, të njëjta, nuk kanë ndryshuar sikurse janë argumentuar në vendimin e sipërcituar.Gjatë fazës së ekzekutimit janë kryer veprimet përkatëse në lidhje me pasuritë e sekuestruara, por është e nevojshme që të kryhen verifikime të mëtejshme ku më konkretisht;

Është kryer ekzekutimi i masës së sekuestrimit në lidhje me pasuritë e mësipërme, por në lidhje me këto pasuri është e nevojshme që të kryhen verifikime të mëtejshme, ekspertimi kontabël, për të saktësuar të ardhurat e ligjshme të subjekteve të hetimit pasuror dhe familjarëve të tyre, të përfutuara ndër vite, për caktimin e shpenzimeve të kryera, pra me qëllim kryerjen e një analize të plotë financiare të transaksioneve të kryera prej subjektit hetimor.Për këtë qëllim është vendosur kryerja e ekspertimit kontabël dhe deri në këtë fazë të hetimit ende nuk është bërë e mundur administrimi i aktit të ekspertimit kontabël.

Në këto kushte në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2, të ligjit më sipër, i cili parashikon se masa e sekuestrimit është e vlefshme për një periudhë gjashtëmujore duke filluar nga momenti i zbatimit të saj, (referuar pv të ekzekutimit vendimit është zbatuar në datën 3.10.2018, e në vijim) meqënëse në datën 3.4.2019, përfundon afati 6 -mujore, prokurori kërkoi zgjatjen e afatit të sekuestros edhe me një periudhë 6-mujore më qëllim përfundimin e të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore.Sa sipër duke pretenduar kompleksitetin e hetimit pasurur, kërkoi nevojën e zgjatjes së afatit të sekuestros me 6- muaj.

Në analizë sa më sipër referuar rrethanave të parashtruara, gjykata cmon se kërkesa është e bazuar në ligj dhe në prova, konkretisht gjen mbështetje në nenin 12/2 të ligjit Nr.10192, date 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” e si e tillë duhet të pranohet.

Gjykata ka parasysh nenin 12 të ligjit Nr.10192, date 03.12.2009, i cili parashikon, se në rastin e verifikimeve komplekse, gjykata mund të vendosë zgjatjen e afatit të zbatimit të masës së sekuestrimit për periudha gjashtë mujore, por jo më shumë se dy vjet nga data e fillimit të afatit të caktuar, sipas pikës 2 të këtij neni.

Në rastin konkret, kjo gjykatë konstaton se afati i masës së sekuestrimit me vendimin Nr.20, datë 15.9.2018, përfundon me datë 3.4.2019, dhe paraqitja e kërkesës nga ana e prokurorit për zgjatjen e masës së sekuestrimit më datë 15.3.2019, është brenda afatit të parashikuar në pikën 2 dhe 3 të nenit të sipërcituar.

Në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit më sipërm, referuar nenit 12/3 të tij, nga rrethanat e parashtruara dhe provuara nga provat, kjo gjykatë vlerëson se kemi të bëjmë me një hetim pasuror të një natyre shumë komplekse për shkak të numrit të konsiderueshëm të pasurive të sekuestruara, që lidhen me individualizimin e plotë të pasurive të paluajtshme në zotërim të shtetasve M.H., A.H., F.H. që janë objekt i masave parandaluese, si dhe ndodhemi përpara nevojave për kryerjen e verifikimeve të mëtejshme, kryerjen e një ekspertimi kontabël, për të saktësuar të ardhurat e ligjshme të subjektve më sipër dhe familjarëve të tij të përfutuara ndër vite, për caktimin e shpenzimeve të kryera, pra me qëllim kryerjen e një analize të plotë financiare të transaksioneve të kryera prej subjektit hetimor, për evidentimin e pasurive të pajustificuara, e cila përbën dhe kushtin ligjor të parashikuar nga neni 12 pika 3 e ligjit të posaçëm.

Për pasojë kërkesa e prokurorisë për zgjatjen e afatit të masës së sekuestrimit për pasuritë për të cilat është vendosur kjo masë me vendimin gjyqesor Nr.20, datë 15.9.2018, duhet pranuar, duke u zgatur edhe me 6- muaj.

Në referim të nenit 14 pika 4 të ligjit nr. 10192 date 03.12.2009, vendimi për zgjatjen e sekuestrimit të pasurisë, sikurse dhe vendimi i masës së sekuestrimit duhet ti komunikohet zotëruesve të pasurisë së sekuestruar, ti njoftohet shtetasve nën pasuror M.H., A.H., F.H.

Lidhur me të drejtën e ankimit kundër vendimit për zgjatjen e afatit të sekuestrimit ligji, në nenin 12 pika 3, si dhe neni 27 pika 1 e ligjit Nr.10192, date 03.12.2009, ka parashikuar të drejtën e ankimit në një gjykatë të një niveli më të lartë, sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, ankim që nuk pezullon zbatimin e vendimit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar nenin 12/3 , 14, 15, 27 te ligjit nr. 10192 date 03.12.2009 “Për

parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndyshuar me ligjin Nr.70 viti 2017, nenet 112tëK.Pr.Penale,

VENDOSI:

I. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

II. Zgjatja e afatit të masës së sekuestrimit të pasurive të luajtshme dhe tëpaluajtshme të vendosura me vendimin nr.20 datë 15.9.2018, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ndaj pasurive të shtetasit M.H., A.H., F.H. , edhe për 6-muaj për pasuritë si më poshtë vijon:

1. Pasuria 27/131-ND Z.K. 8605, vol.10 fq.32, e llojit ndërtesë me sipërfaqe 156m², e cila figuron në pronësi të shtetasit A.H., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.2688 Rep dhe 1787/2 Kol. datë 12.09.2014, me vlerë 40.000 euro.
2. Pasuria 27/154-G, Z.K.8605, vol.37 fq.38, e llojit garazh me sipërfaqe totale 514m², e cila figuron në pronësi të shtetasit A.H., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.2689 Rep dhe 1788/2 Kol. datë 12.09.2014, me vlerë 60.000 euro
3. Pasurinë 32/2+1-2, Z.K.8604, vol.33 fq.27, e llojit apartament me sipërfaqe totale 77.7m², e cila figuron në pronësi të shtetasit A.H., me kontratën e shitjes Nr.3533 Rep dhe Nr.2290/1 Kol. datë 18.11.2014, me vlerë 3.000.000 (tre milion) lekë.
4. Pasurina 32/2+1-35, Z.K.8604, vol.33 fq.60, e llojit apartament me sipërfaqe totale 40.95m², e cila figuron në pronësi të shtetasit C.H., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.3534 Rep dhe Nr.2291/1 Kol. datë 18.11.2014, me vlerë 2.080.000 (dy milion e tetëdhjetë mijë) lekë.
5. Pasurinë 32/2+1-36, Z.K.8604, vol.33 fq.61, e llojit apartament me sipërfaqe totale 40.95m², e cila figuron në pronësi të shtetasit C.H., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.3534 Rep dhe Nr.2291/1 Kol. datë 18.11.2014, me vlerë 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë.
6. Pasurinë 18/103+1-36, Z.K.8604, vol.32 fq.16, e llojit apartament me sipërfaqe totale 102m², e cila figuron në pronësi të shtetasit M.H., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.2696 Rep dhe Nr.1344/1 Kol. datë 04.07.2011, me vlerë 4.000.000 (katër milion) lekë.
7. Pasuria 18/103-N9, Z.K.8604, vol.29 fq.9, e llojit apartament me sipërfaqe totale 285m², e cila figuron në pronësi të shtetasit A., M. dhe F.H., të cilët e kanë blerë me kontratën e shitjes Nr.2698 Rep dhe Nr.1345/1 Kol. datë 04.07.2011, me vlerë 20.000.000 (njëzet milion) lekë.
8. Pasurinë 2/379, Z.K.8601, vol.30 fq.65, e llojit truall me sipërfaqe totale 580m², e cila figuron në pronësi të shtetasit A., M. dhe F.H., të cilët e kanë blerë me kontratën e shitjes Nr.727 Rep dhe Nr.305 Kol. datë 27.04.2016, me vlerë 205.000 euro.
9. Pasurinë 2/5/3 ND, Z.K.8601, vol.30 fq.56, e llojit ndërtesë me sipërfaqe totale 67m², e cila figuron në pronësi të shtetasit A., M. dhe F.H. , të cilët e kanë blerë me kontratën e shitjes Nr.726 Rep dhe Nr.304 Kol. datë 27.04.2016, me vlerë 45.000 euro.
10. Pasurinë 21/7-N3/2, Z.K.8603, vol.61 fq.250, e llojit njësi me sipërfaqe totale 136 m², e cila figuron në pronësi të shtetasit F.H.; i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.390 Rep dhe 167 Kol. datë 08.03.2017, me vlerë 170.000 euro.

11. Pasuria 21/7-ND-N2, Z.K.8603, vol.57 fq.71, e llojit njësi me sipërfaqe totale 157m², e cila figuron në pronësi të shoqërisë “TURI&MZB” sh.a.;
12. Pasurinë 32/12++4-4, Z.K.8604, vol.29 fq.200, e llojit apartament me sipërfaqe totale 71.5 m², e cila figuron në pronësi të shtetases Z.H., e cila e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.646 Rep dhe 539 Kol. datë 22.04.2009, me vlerë 3.150.000(tre million e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
13. Një apartament me sipërfaqe 69m², ndodhur në lagjen “Uji i ftohtë”, Vlorë, me vlerën 25.000 euro. Nga dokumentacion i administruar rezulton se shtetasja K.H. (bashkëshortja e shtetasit A.H.),me kontratë paraprake shitje Nr.742 Rep dhe Nr.484 Kol. datë 04.04.2016, ka blerë nga shoqëria “AFA Konstruksion” sh.p.k.
14. Pasuria 19/140+2-7, Z.K.8604, vol.37 fq.40, e llojit apartament, me sipërfaqe 104.5m², e cila figuron në pronësi të shtetasit F.M. , i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.883 Rep dhe 456/1 Kol. datë 30.07.2013, me vlerë 5.400.000(pesë million e katërqind mijë) lekë.
15. Pasuritë e paluajtshme të shtetasit **A.C.H.** për të cilat ka aplikuar pranë Aluizni-t Vlorë për legalizimin e objekteve sipas kërkesave: Nr.977 datë 03.10.2014, Nr.1216 prot. datë 08.02.2017 dhe Nr.2030 prot. datë 09.08.2017.
16. Pasuritë e paluajtshme të shtetasit **M.C.H.** për të cilat ka aplikuar pranë Aluizni-t Vlorë për legalizimin objekteve sipas kërkesave: Nr.305 datë 19.06.2013, Nr.4798 prot. datë 22.01.2015 dhe Nr.2029 prot. datë 09.08.217.
17. Pasuritë e paluajtshme të shtetasit **F.C.H.** , për të cilat ka aplikuar pranë Aluizni-t Vlorë për legalizimin objekteve sipas kërkesave:Nr.2002 prot. datë 07.08.2017, Nr.2031 prot. datë 09.08.2017, Nr.2032 prot. datë 09.08.2017 dhe Nr.2003 prot. datë 09.08.2017.
18. Automjeti me targë -xxxxxxxxxx, e markës Audi, modeli A8, e vitit të prodhimit 2008.
19. Automjeti me targë - xxxxxxxxxxxx, e markës Ford, Focus,e vitit të prodhimit 2002.
20. Automjeti me targë - xxxxxxxxxxxx, e markës Ford, Focus,e vitit të prodhimit 2000.
21. Automjeti me targë - xxxxxxxxxxxx, e markës Skod, Fabia, e vitit të prodhimit 2002.
22. Automjeti me targë - xxxxxxxxxxxx, e markës Fiat Bravo, e vitit të prodhimit 2007.

IV. Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme dhe paluajtshme të ngarkohet Z.Arjan Baci dhe Erion Ricku, administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave, Tiranë.

V.Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet oficeri i policisë gjyqësore Florian Arapi, pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, i cili të dokumentojë veprimet e kryera.

VI. Urdhërohet sekretaria Gjyqësore e kësaj Gjykate t'i dërgojë menjëherë 2 (dy) kopje të këtij vendimi prokurorëve, Arens Çela, Dritan Prençi dhe Vladimir Mara dhe institucioneve të mësipërme vendimin e zgjatjes së afatit të zbatimit të masës së sekuestros.

VII. Kundër vendimit lejohet ankim brënda pesëditëve, në Gjykatën e Apelit për Krimet të Rënda Tiranë, duke filluar nga dita e nesërme e shpalljes së këtij

vendimi, dhe për palët nga e nesërmja e njoftimit, të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot më datë 20.03.2019

SEKRETARE

BLERINA SUKAJ

GJYQTARE

IRENA GJOKA

